

**BASHKIA TIRANË
NDËRMARRJA E DEKORIT DHE EVENTEVE**

NR.1

Data 15.09.2026

Procesverbal- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: Shërbim mirembajtje mjete transporti

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):): 50100000-6

Vlera e fondit limit: 3,326,800 (tremilionetreqindenezetegjashtemijeeteteqind) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja e Dekorit dhe Eventeve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 77,82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore **të tipit B, Kodi III.1.B**, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar

Legjislacioni në fuqi për prokurimin i jep mundësinë autoriteteve kontraktore që të kërkojnë licenca profesionale për kryerjen e shërbimit object kontrate, të lëshuara nga autoritete kompetente shtetërore, në mënyrë që të vërtetojnë se shërbimi, operatori i plotëson kërkesat sipas të gjitha përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, duke patur parasysh karakteristikat specifike të tij. Këto kriterë janë vendosur që operatorët ekonomik të jenë të pajisur sipas ligjit me lejet dhe autorizimet përkatëse për trejetimin e këtij shërbimi, në zbatim të vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar.

Kriteret e vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituar, përcaktojnë se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë i pajisur me licencat profesionale, të lëshuara nga autoritete kompetente shtetërore, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara në legjislacionin e sipërpërmendur. Pra konsiderohen si kriterë

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit”, Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, VKM nr. 667, datë 29.7.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit Kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Standarti SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standard fokusohet në cilësinë e procesit të riparimit të automjeteve, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Implementimi i këtij standarti ndihmon në optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve, duke ulur kostot dhe kohën e riparimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023-2024-2025) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”i ndryshuar.

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.2 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026, (këstet e maturuara të vitit 2026, sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar),duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kësteve pranë

bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara..
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 5 (pese) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti.
- b) 1 (një) motorrist
- c) 1 (një) xhenerik
- e) 1 (një) elektroauto
- f) 1 (një) bojaxhi - llamarinist

Në lidhje me Inxhinier mekanik, duhet të paraqitet:

- Kontratë pune.
- Diplomë universitare sipas profilit të kërkuar (origjinale ose fotokopje të noterizuar)

Për secilin prej punonjësve të tjerë në pikat b, c, d, e, f, më sipër duhet të paraqitet:

- kontratat e punës, e vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, pompist, elektroauto, bojaxhi-llamarinist dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.
- Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar.

Argumentimi : Kërkesat e pikës 2.3.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK, me qëllim sigurimin e AK se shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, objekt prokurimi do të realizohet nga punonjës të kualifikuar për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Kërkesa për Përgjegjësin Teknik është bazuar në pikën 2, neni 6 dhe nenin 9 në Ligjin Nr.9573, datë 3.7.2006 "Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktitura dhe për veprimtaritë që lidhen me to", i cili ka një rol të rëndësishëm në kryerjen dhe realizimin e shërbimit, objekt prokurimi në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara.

Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë riparime dhe mirëmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocërës, të sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit, etj është e nevojshme disponimi i një stafi teknik me profesione si motorist, xhenerik, elektroauto, pompist me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që kane nevojë për kryerjen e shërbimeve, si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës të cilat duhet të përmbushë ky shërbim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata, e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i kontratës.

Argumentimi Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se shërbimi, objekt prokurimi është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, të cilat duhet të dërgohen në ambientet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e

domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij.

Disponimi minimalisht i 1 (një) ambjenti ku ushtron aktivitetin e tij, lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri dhe garanci për AK që ofertuesi ka kapacitetet e domosdoshme për të përmbushur me sukses kontratën, në kohë dhe konform specifikimeve teknike të kërkuara.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergences) së rrotave të mjetit
- b) pajisje bango provë, për motorrino dhe alternator (dinamo);
- c) pajisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete;
- d) pajisje për kontrollin dhe furnizimin e gazit të A/C;
- e) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit.
- f) 1 (një) Ure ngritese (me kapacitet jo më pak se 4 Ton);
- g) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të amortizimit të automjetit.
- h) pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v;
- i) pajisje për kontrollin, riparimin & kalibrimin e turbinave të motorrit
- j) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes;
- k) pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;
- l) pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit;
- m) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.
- n) pajisje për saldime me oksigjen & argon & saldime elektrik
- o) të kete repart të riparimit të karrocërve të automjetit (Shasise dhe perpunimit të llamarinës) si dhe bojatisjes së mjetit të pajisur me: furre për lyerje, repartin për përgatitjen paraprake për bojatisje të kompletuar me pajisjet perkatese, si edhe pajisje për drejtim shasie të cilat të kenë kapacitet në pershtatje të plote për realizimin e shërbimeve të mjeteve.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- Dokumenta që vërtetojnë se këto pajisje i ka aktualisht në pronësi ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, objekt prokurimi.

Duke vlerësuar proceset e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes, disponimi i këtyre pajisjeve, lidhet ngushtësisht me realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, duke krijuar garancinë e AK se oferteusit disponojnë pajisjet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës/ave, që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër. Specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara në zërat e riparimit dhe mirëmbajtjes të kërkuara në Shtojcën 7 (Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit).

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) karrotrec, për transportimin e automjeteve të difektuara.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- Leja e qarkullimit të mjetit.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion të paktën një karrotrec për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se objekt i kësaj procedure prokurimi është riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve, ndër të cilat mund të ndodhë që në raste të caktuara duhet të transportojnë një automjet të difektuar në ambjentet e servisit që disponon OE, është e domosdoshme që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) automjet, konkretisht karrotrec me qëllim realizimin e objektit të prokurimit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Agregatat / Pajisjet / Pjesët e këmbimit që do ofrohen do të jenë të reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, VKM nr.1053, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet e mbrojtjes personale (pmp)” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi konfirmimi ose të testeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi i mallrave specifike dhe me funksione mbrojtëse speciale pasi disa nga produktet garantojnë jetën e dhe shëndetin e punonjësve që do t’i përdorin, duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të punës së punonjësve dhe sigurinë e tyre në kantieret e përkohshme pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai mund të dëmtojte seriozisht jetën edhe shëndetin e përdoruesve.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument provues për dorëzimin e vajrave të përdorura të subjekti që është pajisur me leje për transportimin, rikuperimin dhe/ose asgjësimin e VP-ve në përmbushje të VKM 765 datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorur”.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur bazuar në VKM nr 765 datë 07.11.2012 Per miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorur, duke synuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga pasojat e dëmshme të shkaktuara nga shkarkimet, depozitimi apo trajtimi i vajrave të përdorura (VP).

Duke pasur parasysh se në Republikën e Shqipërisë ndalohen derdhja e vajrave të përdorura në ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore, depozitimi dhe/ose derdhja e VP-ve të dëmshme në tokë, si dhe çdo shkarkim i pakontrolluar i mbetjeve që rezultojnë nga përpunimi i tyre, përpunimi i VP-ve që shoqërohet me ndotje të ajrit mbi nivelet e lejuara të shkarkimeve në ajër, sipas legjislacionit në fuqi, derdhja, hedhja, braktisja, groposja, përzierja me mbetje të tjera të ngurta i VP-ve, gjithashtu duke pasur parasysh dhe objektin e prokurimit i cili përfshin furnizim vendosje vaji, F.V vaj kambio etj gjykohet e nevojshme marrja e masave nga ana e operatorëve ekonomikë për për respektimin e kuadrit ligjor dhe të mjedisit në dobi të komunitetit.